



Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT, me numër fiskal 603383324, në mbështetje të: nenit 17 të LIGJIT NR. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit; dhe në mbështetje të nenit 24 paragrafi 1 nënparagrafët 1.19 dhe 1.20 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datë 31.12.2024, me numër protokoll 8648/24; me qëllim të avancimit të kuadrit ligjor dhe profesional në fushën e ndërtimit dhe harmonizimit të tij me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 02.06.2026, nxjerr këtë:

### VENDIM

1. Miratohet Udhërrëfyesi për Punën e Grupit Punues për Shqyrtimin dhe Përgatitjen e Propozimeve për Ndryshimin dhe Plotësimin e Legjislacionit në Fushën e Ndërtimit, i cili i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Udhërrëfyesi nga pika 1 e këtij vendimi shërben si dokument orientues dhe bazë pune për Grupin Punues gjatë ushtrimit të mandatit të tij.
3. Grupi Punues obligohet që detyrat dhe aktivitetet e tij t'i zhvillojë në përputhje me Udhërrëfyesin e miratuar, legjislacionin në fuqi dhe aktet e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës.
4. Pas përfundimit të punës së tij, Grupi Punues i paraqet Bordit Drejtues raportin e punës, rekomandimet profesionale dhe propozimet përkatëse për shqyrtim dhe vendimarrje.
5. Administrata e Odës obligohet të sigurojë mbështetjen e nevojshme administrative dhe teknike për realizimin e detyrave të Grupit Punues. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikëqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**, Kryetar i OIRK-së \_\_\_\_\_
2. **Mimoza Shahini**, Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
3. **Kadri Morina**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
4. **Afrim Demiri**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
5. **Nebi Pllana**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
6. **Bujar Jupaj**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_
7. **Sami Kolgeci**, Anëtar i Bordit Drejtues të OIRK-së \_\_\_\_\_



# **UDHËRRËFYES PËR PUNËN E GRUPIT PUNUES PËR SHQYRTIMIN DHE PËRGATITJEN E PROPOZIMEVE PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E NDËRTIMIT**

## **1. Qëllimi**

Qëllimi i Grupit Punues është të analizojë legjislacionin në fuqi në fushën e ndërtimit në Republikën e Kosovës dhe të përgatisë rekomandime profesionale për përmirësimin, ndryshimin dhe plotësimin e tij, me synim ngritjen e cilësisë së ndërtimit, sigurisë publike, përgjegjësisë profesionale dhe harmonizimin me praktikën bashkëkohore evropiane.

## **2. Dokumentet bazë për shqyrtim**

Grupi Punues gjatë ushtrimit të mandatit të tij shqyrton në veçanti:

- Ligjin për Ndërtim dhe ndryshimet e tij;
- aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të Ligjit për Ndërtim;
- Ligjin për Planifikimin Hapësinor;
- Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit;
- Statutin dhe aktet e Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës;
- standardet evropiane dhe Eurokodet;
- legjislacionin dhe praktikën e vendeve të Bashkimit Evropian.

## **3. Detyrat e Grupit Punues**

### **3.1 Analiza e legjislacionit aktual**

Grupi Punues:

- analizon dispozitat e legjislacionit aktual në fushën e ndërtimit;
- identifikon paqartësitë juridike dhe teknike;
- identifikon boshllëqet ligjore dhe dispozitat që krijojnë vështirësi në zbatim;
- identifikon dispozitat që nuk janë të harmonizuara me sistemin aktual të licencimit dhe përgjegjësive profesionale të inxhinierëve;
- vlerëson nëse legjislacioni aktual siguron nivel të mjaftueshëm të sigurisë, cilësisë dhe kontrollit profesional në procesin e ndërtimit.

### **3.2 Analiza e akteve nënligjore**

Grupi Punues:

- shqyrton aktet nënligjore në fuqi;
- identifikon mungesat dhe kundërthëniet eventuale ndërmjet tyre;
- identifikon dispozitat që kërkojnë ndryshim, plotësim ose harmonizim.

### **3.3 Analiza krahasuese**

Grupi Punues kryen analizë të legjislacionit krahasues, me fokus të veçantë në:

- Ligjin e Ndërtimit të Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë së Veriut, Republika e Shqipërisë, Republika e Malit të zi, dhe vendeve tjera të Rajonit
- aktet nënligjore kroate që rregullojnë projektimin, kontrollin e projekteve, ndërtimin, mbikëqyrjen profesionale dhe pranimin teknik të objekteve;
- zgjidhjet ligjore dhe institucionale që kanë rezultuar efektive në praktikë;
- standardet dhe praktikat relevante të vendeve të Bashkimit Evropian.

Në kuadër të analizës krahasuese, Grupi Punues identifikon dispozitat dhe zgjidhjet që mund të përshtaten dhe integrohen në legjislacionin e Republikës së Kosovës.

### **4. Fushat prioritare të shqyrtimit**

Gjatë analizës, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- dokumentacionit teknik dhe projektimit;
- kontrollit profesional të projekteve;
- përgjegjësive të projektuesve, mbikëqyrësve dhe kontraktorëve;
- licencimit dhe përgjegjësive profesionale;
- sigurisë strukturore të objekteve;
- sigurisë nga zjarri;
- përdorimit të standardeve dhe Eurokodeve;
- procedurave të ndërtimit dhe kontrollit të tyre;
- pranimin teknik të objekteve;
- mirëmbajtjes dhe sigurisë së objekteve ekzistuese;
- digjitalizimit të procedurave dhe dokumentacionit ndërtimor.

### **5. Raporti dhe rekomandimet**

Pas përfundimit të punës, Grupi Punues i paraqet Bordit Drejtues:

- raportin e analizës së legjislacionit aktual;

- raportin krahasues me legjislacionin kroat dhe praktikat relevante evropiane;
- listën e mangësive dhe çështjeve që kërkojnë ndërhyrje ligjore;
- rekomandimet profesionale për ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit;
- propozimet konkrete që mund të shërbejnë si bazë për iniciativat e ardhshme ligjore të Odës.

## **6. Parimi udhëheqës**

Puna e Grupit Punues duhet të mbështetet në parimet e sigurisë publike, profesionalizmit, përgjegjësisë profesionale, cilësisë së ndërtimit dhe harmonizimit gradual të legjislacionit të Republikës së Kosovës me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.